

RAPORT I NDËRMJETËM 1¹ 13-31 dhjetor 2006

Përmbledhje

- Më 2 dhjetor 2006, në përputhje me kërkesat kushtetuese, Presidenti i Republikës caktoi 20 janarin 2007 si datën për mbajtjen e zgjedhjeve për pushtetin vendor. Zgjedhjet do të zhvillohen për kryetarët dhe këshillat e 384 Njësive të Qeverisjes Vendore (NjQV).
- Zhvillimi i zgjedhjeve në këtë periudhë relativisht të shkurtër, është vënë seriozisht në dyshim, pasi partitë kryesore politike kanë dështuar në mënyrë të vazhdueshme të demonstrojnë vullnet politik dhe përgjegjësi në të njëjtën masë me autoritetin e gjerë që u është dhënë në procesin zgjedhor.
- Për rrjedhojë, dështimi i përpjekjeve për reformë zgjedhore, që synonin përmirësimin e mëtejshëm të procesit zgjedhor në përputhje me rekomandime të mëparshme të OSBE/ODIHR-it, si edhe pozicionet vijuese të marra deri më tani nga opozita për të mos marrë pjesë në atë që ajo e ka quajtur “proces të paligjshëm”, kanë çuar në bllokim të procesit zgjedhor.
- Mekanizmat vendimmarrës të bazuar në konsensus dhe kërkesa për arritjen e marrëveshjeve politike ndërpartiake mbi organizimin e zgjedhjeve i japin një rol të rëndësishëm partive politike në përgatitjen dhe zhvillimin e zgjedhjeve. Këta mekanizma synojnë rritjen e përfshirjes dhe besimit, si edhe nxitjen e pjesëmarrjes.
- Zgjedhja e opozitës për të mos u përfshirë në një masë të madhe në mekanizmat *bi-partizanë* dhe në disa raste për të luajtur një rol më pak se konstruktiv, ka penguar funksionimin e institucioneve përgjegjëse për zhvillimin e zgjedhjeve. Kjo ngjall shqetësime serioze rreth vullnetit të partive përgjegjëse për t’u angazhuar me efektivitet, në një mënyrë, e cila do të lejonte vazhdimin e procesit zgjedhor.
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) është përpjekur deri tani të përmbushë detyrat e tij në mënyrë profesionale. Megjithatë, për shkak të mungesës së marrëveshjeve mbi ndryshimin e kuadrit ligjor, KQZ-ja u gjend në një situatë, ku një sërë aktiviteteesh të nevojshme për zhvillimin e zgjedhjeve nuk mund të ndërmerreshin.
- Deri në momentin e hartimit të këtij raporti, Komisionet Zonale të Qeverisjes Vendore (KZQV) dhe Komisionet e Qendrave të Votimit (KQV) nuk janë formuar ende për shkak të mospjesëmarrjes së opozitës parlamentare. Kjo e ka bërë të pamundur regjistrimin e

¹ Ky raport është i përkthyer në gjuhën shqipe. Sidoqoftë, varianti në gjuhën angleze mbetet i vetmi dokument zyrtar.

kandidatëve brenda afatit të përcaktuar ligjor. Përveç kësaj, ka ende lista paraprake zgjedhësish që duhet të përditësohen.

- Pati disa shenja se mund të arrihej një kompromis gjatë bisedimeve midis Partisë Demokratike (PD) në pushtet dhe partisë kryesore të opozitës, Partisë Socialiste (PS), më 29 dhjetor 2006. Kjo erdhi veçanërisht pas një lëvizjeje nga qeveria mbi çështjen e një shtyrjeje të mundshme të zgjedhjeve, por jo më vonë sesa data 20 shkurt. Kjo lëvizje, megjithëse e vonuar, lejoi rifillimin e një dialogu politik mbi disa çështje të pazgjidhura dhe të rëndësishme, dhe pas kësaj, opozita i rikonsideroi pjesërisht disa nga kërkesat e saj.
- Një përqasje e ashtuquajtur ‘përqasje në formë pakete’, e cila mund të rriste besimin në proces dhe të ndreqte disa nga mangësitë e tij, mbetet e bllokuar në lidhje me çështjen e përdorimit të certifikatave të lindjes si mjet për identifikimin e zgjedhësve. Kjo vlen veçanërisht në rastin e certifikatave të lindjes të lëshuara përpara sesa regjistrimi i tyre në një libër të posaçëm indeksi të bëhej i detyrueshëm në fillim të nëntorit 2006, certifikata, për të cilat nuk ka ende evidencë të plotë.

Hyrje

Më 2 dhjetor 2006, Presidenti i Republikës së Shqipërisë caktoi mbajtjen e zgjedhjeve për pushtetin vendor më 20 janar 2007. Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (OSBE/ODIHR) dërgoi një Mision për Vlerësimin e Nevojave në fillim të nëntorit 2006 dhe në përgjigje të një ftese nga Ministria e Punëve të Jashtme, vendosi një Mision për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (MVZ) më 13 dhjetor 2006. MVZ-ja, e kryesuar nga z.Jørgen Grunnet, përbëhet nga një skuadër qendrore prej 11 vetësh me qendër në Tiranë dhe 22 vëzhgues afatgjatë të vendosur në 11 lokalitete të shpërndara në gjithë vendin.

Misioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve i OSBE/ODIHR-it operon veçmas nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, kryesuar nga Ambasadori Pavel Vacek, e cila vazhdon të ushtrojë aktivitetin e saj normal sipas mandatit të saj ekzistues. Megjithatë, MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it i është mirënjohëse Prezencës së OSBE-së në Tiranë për bashkëpunimin dhe mbështetjen që ka marrë prej saj.

Situata politike

Gjatë periudhës mbi të cilën po raportohet, klima e përgjithshme politike në Shqipëri ka qenë e polarizuar dhe shumë e pakompromis. Të dyja palët e spektrit politik kanë përqafuar, në një mënyrë disi kokëfortë, qëndrime të ngurta rreth disa çështjeve të ndryshme teknike dhe ligjore që kanë lidhje me organizimin e zgjedhjeve të radhës për pushtetin vendor. Është për të ardhur keq që disa parti politike nuk demonstuan vullnet politik dhe përgjegjësi në të njëjtën masë me autoritetin e gjerë që u është dhënë në procesin zgjedhor, për të arritur një kompromis të kënaqshëm mbi çështjet e pazgjidhura.

Forcat opozitare kanë kërkuar shtyrjen e datës së zgjedhjeve për të përmbushur ato që këto forca u referohen si ‘standarde zgjedhore ndërkombëtare’, veçanërisht në lidhje me çështjen e certifikatave të lindjes dhe listave të zgjedhësve. Ato kanë pretenduar se nuk janë marrë masa të mjaftueshme sigurie për të garantuar zgjedhje të një standardi demokratik. Mbi këtë bazë, ato, në fakt, kanë bojkotuar disa seanca të Kuvendit, duke pretenduar se amendamentet e propozuara për Kodin Zgjedhor nuk kishin marrë parasysh kërkesat e tyre. Fillimisht,

shumica qeverisëse iu përmbajt me vendosmëri angazhimit të saj për mbajtjen e zgjedhjeve më 20 janar, duke deklaruar në shumë raste se çdo shtyrje e datës do të krijonte një precedent për të ardhmen, i cili mund të bëhej objekt interpretimesh të shumëfishta të ligjit dhe manipulimesh të mundshme politike.

Megjithatë, javën e fundit të dhjetorit, u duk se mund të arrihej një lloj marrëveshjeje nëpërmjet një “pakete reforme”, që iu propozua partive opozitare nga shumica më 23 dhjetor. Kjo përfshinte një gatishmëri të re nga ana e qeverisë për të diskutuar amendamentet e Kodit Zgjedhor, të cilat mund të kishin lejuar shtyrjen e datës së zgjedhjeve jo më vonë se data 20 shkurt, datë që shënon edhe mbarimin e mandatit të organeve aktuale të pushtetit vendor. Disa parti, si Partia Demokristiane (PDK), Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI) dhe Partia e Bashkimit për të Drejtat e Njeriut (PBDNJ), kanë luajtur një rol konstruktiv në këtë aspekt, duke i bërë thirrje partive më të mëdha dhe Presidentit që të nisnin diskutimet që mund ta zgjidhnin këtë bllokim.

Nga fundi i dhjetorit, Partia Demokratike dhe Partia Socialiste rifilluan negociatat rreth amendamenteve të mundshme në Kodin Zgjedhor. Negociatat çuan në një marrëveshje më 29 dhjetor, e cila u miratua nga drejtuesit e të dyja partive. Megjithatë, të dy palët nuk arritën të binin dakord mbi zbatimin praktik të marrëveshjes. Kështu ndodhi veçanërisht përsa i përket çështjes së një sistemi regjistrimi të posaçëm të certifikatave të lëshuara para nëntorit të vitit 2006, domethënë përpara se regjistrimi i tyre në një libër të posaçëm indeksi të bëhej i detyrueshëm, si edhe çështjes së dokumenteve shtesë të identifikimit, që do të përdorreshin me këto certifikata (shih më poshtë).

Gjatë gjithë periudhës aktuale është bërë e qartë se nuk është parë në mënyrë të mjaftueshme një vullnet politik në përpjesëtim të drejtë me përgjegjësinë e konkurrimit për organet e zgjedhura. Në veçanti, disa parti të opozitës janë dukur të gatshme të përdorin mekanizmat *bipartisan*, në një mënyrë, që ka bllokuar procesin dhe ka komplikuar çdo zgjidhje të mundshme.

Kuadri ligjor

Kuadri ligjor që rregullon zgjedhjet për pushtetin vendor përfshin Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë (1998) dhe Kodin Zgjedhor (miratuar në vitin 2003 dhe ndryshuar në vitin 2004 dhe 2005), si edhe dispozitat përkatëse të ligjeve të tjera, përfshirë Kodin Penal, Ligjin për Partitë Politike, Ligjin për Gjendjen Civile, si edhe Ligjin për Policinë e Shtetit.

Data e zgjedhjeve është caktuar me dekret të Presidentit në përputhje me Kushtetutën dhe Kodin Zgjedhor. Megjithatë, data e zgjedhjeve, bashkë me disa çështje të tjera, si p.sh. hartimi dhe përditësimi i listave të zgjedhësve, përdorimi i certifikatave të lindjes si mjet për identifikimin e zgjedhësve, përbërja e komisioneve zgjedhore, si edhe ankesat zgjedhore dhe procedurat ankimore, provokuan polemika serioze në përpjekjet për arritjen e një konsensusi midis koalicionit qeverisës dhe opozitës.

Mungesa e konsensusit bllokoi në fakt përpjekjet për reformë zgjedhore, e cila ka qenë në axhendë që në dhjetor 2005, kur të gjitha partitë kryesore politike, nën kujdesin e Presidentit të Republikës, ranë dakord të zbatonin rekomandimet e mëparshme të OSBE/ODIHR-it. Kuvendi nuk ka mundur të miratojë amendamentet e Kodit Zgjedhor që nevojiteshin për

zgjedhjet e radhës për pushtetin vendor, pasi shumica qeverisëse nuk ka shumicën prej tre të pestave (84 nga 140 vende) që kërkon ndryshimi në mënyrë të njëanshme i Kodit Zgjedhor.

Në përputhje me praktikën e kaluar të reformave zgjedhore të ndërmarra nga Kuvendi, në janar 2006 u parashikua një Komision Parlamentar *Ad Hoc* për realizimin e një axhende për reformën zgjedhore, si edhe për të ndryshuar kornizën e zgjedhjeve të ardhshme për pushtetin vendor.

Megjithatë, nuk ka pasur asnjë lloj përparimi megjithë përpjekjet e supozuara disa mujore për arritjen e një konsensusi, së pari, mbi modalitetet e aktivitetit të komisionit *ad hoc* dhe më vonë mbi përmbajtjen e ndryshimeve të legjislacionit zgjedhor. Në fakt, deri në momentet e raportimit, Kodi Zgjedhor mbetet i pandryshuar që pas ndryshimit të fundit në prill 2005, kur u zbatuan një sërë Rekomandimesh të Përbashkëta të OSBE/ODIHR-it dhe Komisionit të Venecias të Këshillit të Evropës. Kështu, rekomandimet e Raportit Përfundimtar të OSBE/ODIHR-it për zgjedhjet parlamentare të vitit 2005² mbeten ende për t'u trajtuar.

Disa aspekte të rëndësishme të procesit zgjedhor kanë nevojë për rregullime të mëtejshme. Siç është përmendur tashmë në Raportin e OSBE/ODIHR-it për Vlerësimin e Nevojave³ publikuar më 24 nëntor 2006, këtu përfshihen përgatitja e listave të zgjedhësve për zgjedhjet për pushtetin vendor, procedurat e numërimit, si edhe procesi i ankimeve dhe apelimeve.

Në të kaluarën janë përdorur dispozita kalimtare për të përshtatur afatet e hartimit të listave të zgjedhësve me rrethanat e zgjedhjeve specifike. Megjithëse edhe për këto zgjedhje nevojiteshin afate të përshtatura dhe procedura të posaçme, Kuvendi nuk miratoi ndonjë dispozitë kalimtare përkatëse.

Administrata zgjedhore

Misioni i OSBE/ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve i ka ndjekur të gjitha mbledhjet e KQZ-së që nga data 16 dhjetor 2006. Deri tani, KQZ-ja është përpjekur t'i përmbushë detyrat e saj në mënyrë profesionale, me qëllim që ta realizojë procesin zgjedhor brenda afateve ligjore që rrjedhin nga dekreti i Presidentit për mbajtjen e zgjedhjeve më 20 janar 2007.

Megjithatë, mospjesëmarrja e partive opozitare parlamentare ka ndikuar për keq në përgatitjet për zgjedhjet. Ngurrimi i tyre, aktiv apo pasiv, për të kontribuar në organizimin e procesit zgjedhor ka çuar në një situatë, ku pjesë të rëndësishme të Kodit Zgjedhor nuk mund të zbatoheshin.

Në mënyrë të veçantë, nuk u formuan komisionet zgjedhore të nivelit të mesëm, kandidatët nuk qe e mundur të regjistroheshin dhe u cënua përditësimi i listave të zgjedhësve. Si rezultat, KQZ-ja u gjend në një situatë, ku shumë hapa të ardhshëm të parashikuar në Kodin Zgjedhor nuk qe e mundur të ndërmerreshin.

Komisionet Zonale të Qeverisjes Vendore (KZQV) përbëhen nga shtatë anëtarë dhe një sekretar pa të drejtë vote. Partitë e shumicës parlamentare dhe opozitës parlamentare propozojnë secila nga tre anëtarë. Anëtari i shtatë i KZQV-ve caktohet ose nga partia kryesore e shumicës qeverisëse (PD-ja) ose partia më e madhe opozitare (PS-ja) mbi baza

² http://www.osce.org/documents/odihr/2005/11/16905_en_pdf

³ http://www.osce.org/documents/odihr/2006/11/22210_en_pdf

barazie, “përzgjedhjeje rastësore” dhe “shpërndarjeje të barabartë”. Në përputhje me përqasjen e përgjithshme të ‘ekuilibrit politik’ të organeve të administrimit të zgjedhjeve, Kodi Zgjedhor parashikon që kur kryetari i KZQV-së caktohet nga blloku që ka shumicën në KZQV, nënkryetari dhe sekretari caktohen nga blloku tjetër. Më 1 dhjetor, KQZ-ja organizoi një short për të vendosur se cila parti do të kishte kryesimin në secilën KZQV.

Sipas ligjit, KZQV-të duhet të ishin formuar brenda datës 20 gusht 2006. Ky afat nuk u respektua për shkak të diskutimeve të vazhdueshme mbi reformën zgjedhore. Mospjesëmarrja e opozitës parlamentare bllokoji më tej ngritjen e KZQV-ve, për shkak se këto parti nuk propozuan kandidatë për anëtarë. Edhe disa parti të shumicës i paraqitën me vonesë disa nga propozimet e tyre, kurse në disa raste ato nuk propozuan një numër të mjaftueshëm kandidatësh për të plotësuar të gjitha vendet. Si rrjedhojë, as edhe një KZQV e vetme nuk ishte funksionale deri në fund të vitit 2006. KQZ-ja u bëri thirrje në mënyrë të përsëritur, por pa sukses, partive politike për të përmbushur detyrimet e tyre dhe për të propozuar kandidatët e tyre për anëtarë të KZQV-ve. Në një deklaratë për shtyp më datë 26 dhjetor, Kryetari i KQZ-së tha se do t’i kërkonte KQZ-së të merrte masa administrative ndaj partive që nuk kishin paraqitur propozimet e tyre për anëtarë të KZQV-ve.

Përveç kësaj, në mungesë të KZQV-ve funksionale, mbeten ende për t’u ngritur Komisionet e Qendrave të Votimit (KQV) dhe nuk janë përcaktuar vendndodhjet e vendeve të numërimit.

Regjistrimi i kandidatëve

Mosformimi i KZQV-ve çoi në një situatë, ku asnjë kandidat apo parti nuk mund të paraqiste kandidaturat e tyre për kryetarë bashkie ose komune apo për këshilltarë brenda afatit ligjor.

Sipas Kodit Zgjedhor, partitë politike që synojnë të propozojnë kandidatë duhet të regjistrohen në KQZ si subjekte zgjedhore jo më vonë se 40 ditë para ditës së zgjedhjeve. Pas kësaj, subjektet zgjedhore mund të regjistrojnë koalicione në KQZ deri 35 ditë para ditës së zgjedhjeve. Kandidaturat për kryetarë bashkie ose komune apo për këshilltarë duhet t’i dorëzohen KZQV-ve përkatëse jo më vonë se 32 ditë para ditës së zgjedhjeve.

Afati për regjistrimin e partive politike në KQZ për zgjedhjet e ardhshme për pushtetin vendor skadoi më 11 dhjetor. Partitë opozitare nuk u regjistruan brenda këtij afati, duke deklaruar publikisht se ato nuk pranojnë të marrin pjesë në atë që ato e kanë quajtur proces ‘të paligjshëm’. Qëndrimi i tyre bazohej në moszbatimin e marrëveshjes së 30 gushtit⁴ mbi ndryshimin e kornizës ligjore për zgjedhjet; për shkak të këtij moszbatimi, opozita deklaroi se zgjedhjet e ardhshme për pushtetin vendor nuk kanë bazë ligjore. Si rezultat, në KQZ u regjistruan rreth 40 parti politike, kryesisht nga krahu i djathtë i spektrit politik, por partitë kryesore të spektrit të majtë nuk u regjistruan.

Për shkak të mosformimit të KZQV-ve, asnjë parti nuk mund të propozonte kandidatët e saj brenda afatit ligjor. As kandidatët e pavarur nuk mund të paraqisnin dokumentet e tyre të kandidimit. Si rrjedhojë, në asnjë njësi të qeverisjes vendore nuk u regjistrua as edhe një kandidat i vetëm para fillimit të fushatës zyrtare më 21 dhjetor.

⁴ Më 30 gusht u arrit një marrëveshje midis forcave politike nxitur nga komuniteti diplomatik në vend me qëllim rifillimin e përpjekjeve për reformën e bllokuar zgjedhore.

Regjistrimi i zgjedhësve

Përditësimi i listave të zgjedhësve për zgjedhjet e radhës për pushtetin vendor kërkonte ndërmarrjen e dy veprimeve: së pari, Zyrat e Gjendjes Civile (ZGjC), nën mbikqyrjen e kryetarëve të njësive të qeverisjes vendore dhe në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile (DPGjC) në Ministrinë e Brendshme, duhet të korrigjonin regjistrat e gjendjes civile. Pas kësaj, kryetarët e njësive do të merrnin nga DPGjC-ja pjesën përkatëse të listës së vitit 2005, ta përditësonin atë për njësinë e tyre të qeverisjes vendore dhe të pasqyronin në listën e zgjedhësve korrigjimet e bëra në regjistra.

Sipas Kodit Zgjedhor, përditësimi i listave të zgjedhësve duhet të kishte filluar më 20 maj dhe listat paraprake të zgjedhësve duhet të ishin shpallur për rishikim nga publiku brenda datës 20 gusht. Mungesa e një marrëveshjeje politike për reformën zgjedhore çoi në shkeljen e këtyre afateve.

Megjithatë, duke përdorur një bazë kompjuterike të dhënash që mban versionin elektronik të listës së zgjedhësve të vitit 2005, DPGjC-ja ndërmori hapa efektivë për të evidentuar korrigjimet që i duheshin bërë regjistrave të gjendjes civile (rastet e zgjedhësve me adresa të jo plota shifrore, duplikatat dhe zgjedhësit nga regjistrat e përkohshëm). Prapëseprapë, procesi i hartimit të listave të zgjedhësve u ndërpre në shumë njësi të qeverisjes vendore.

Pas daljes së dekretit të Presidentit që përcaktonte mbajtjen e zgjedhjeve më datë 20 janar, KQZ-ja u përball me një periudhë kohore të kufizuar për organizimin e zgjedhjeve dhe me pamundësinë praktike për të përdorur afatet e zakonshme për hartimin dhe përditësimin e listave të zgjedhësve.

KQZ-ja reagoi më 8 dhjetor duke miratuar Vendimin nr.129, i cili përcaktonte afatet për përgatitjen e listave të zgjedhësve sipas Nenit 60/1 të Kodit Zgjedhor, i cili rregullon përgatitjen e listave të zgjedhësve për zgjedhjet e pjesshme ose të parakohshme, përmes procedurash dhe afatesh të përshpejtuara.

Partitë opozitare dhe pakica në KQZ e kritikuan ashpër këtë vendim, me arsyetimin se ai nuk kishte bazë ligjore. Megjithatë, Misioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve të OSBE/ODIHR-it nuk është në dijeni të ndonjë veprimi zyrtar të ndërmarrë për të kundërshtuar kushtetueshmërinë apo ligshmërinë e këtij vendimi të KQZ-së. Partitë opozitare argumentuan gjithashtu se nuk kishte kohë të mjaftueshme për përditësimin e listave të zgjedhësve; ky ishte një ndër argumentat e tyre kryesorë për shtyrjen e zgjedhjeve.

Më 11 dhjetor, bazuar në vendimin e sipërpërmendur të KQZ-së, Ministria e Brendshme nxorri Udhëzimin Nr.3071, i cili detajon procedurat e hartimit të listës së zgjedhësve në nivel qendror dhe lokal. Sipas këtij udhëzimi, listat e zgjedhësve duhet të përditësohen në njësitë e qeverisjes vendore. Kryetarëve të njësive të qeverisjes vendore do t'u duhej të reflektonin korrigjimet në pjesës së tyre të listës elektronike të zgjedhësve të vitit 2005 dhe t'ia dërgonin atë përsëri DPGjC-së, e cila kontrollon për duplikata të mundshme në nivel kombëtar. Afati i dorëzimit të listave të përditësuar në DPGjC ishte data 22 dhjetor. Pas kësaj, DPGjC-ja duhej t'i dërgonte evidencë të duplikatave të mundshme njësive përkatëse të qeverisjes vendore dhe t'u kërkonte zgjidhjen e rasteve. Pas pastrimit të duplikatave, kryetarët e njësive duhet të miratonin dhe shpallnin Listat e Zgjedhësve për rishikim nga publiku deri më 26 dhjetor.

Gjithashtu kryetarët duhej t'ia dërgonin listat KZQV-ve përkatëse dhe DPGjC-së. Pas kësaj, zgjedhësit njoftohen me shkrim dhe ata mund të verifikojnë të dhënat e tyre në listë dhe t'i kërkojnë gjykatës së rrethit, deri 24 orë para ditës së zgjedhjeve, përfshirjen në listë ose korrigjimin e të dhënave të tyre. Zgjedhësit e shtuar në listë me vendim gjykate lejohen të votojnë në qoftë se ata paraqesin në qendrën e votimit vendimin e gjykatës dhe dokumentin e identifikimit.

Deri më 30 dhjetor, DPGjC-ja kishte marrë listat e zgjedhësve vetëm nga 275 njësi të qeverisjes vendore (72 për qind), nga 384 njësi gjithsej. Nga këto 275 lista, 148 (ose 54 për qind) mbërritën pas afatit ligjor. Arsyeja e paraqitjes jo të plotë dhe me vonesë e listave të zgjedhësve vjen kryesisht nga mospjesëmarrja e partive opozitare, disa prej të cilave u bënë thirrje kryetarëve të tyre të njërive të qeverisjes vendore që të mos e zbatonin Udhëzimin e Ministrisë dhe të mos ia dërgonin listat DPGjC-së.

Megjithëse kjo thirrje nuk u ndoq nga të gjithë kryetarët e bashkive dhe komunave të opozitës, numri i listave të paraqitura në DPGjC nuk lejon verifikimin në shkallë vendi të duplikatave të mundshme. DPGjC-ja ka deklaruar publikisht se ajo mund ta bënte një verifikim të tillë kombëtar brenda tetë orëve nga momenti i marrjes së të gjitha listave të zgjedhësve. Kështu, duket se ekziston mundësia që procesi i përditësimit të listave të realizohet në kohë për zgjedhje të ricaktuara në një datë të mëvonshme, por përpara përfundimit të mandatit të organeve ekzistuese të pushtetit vendor.

Certifikatat e lindjes

Sipas Kodit Zgjedhor, certifikatat e lindjes janë një formë e identifikimit të zgjedhësve dhe ato përdoren gjerësisht në kontekstin shqiptar si mjet për vërtetimin e identitetit të personave. Certifikatat e përdorura për qëllime identifikimi duhet të përmbajnë një fotografi të mbajtësit të certifikatës. Certifikatat lëshohen nga nëpunësit e më shumë se 400 Zyra të Gjendjes Civile.

Në Raportin Përfundimtar për zgjedhjet parlamentare të vitit 2005, OSBE/ODIHR-i rekomandoi që autoritetet qendrore duhet të garantojnë që zyrat e gjendjes civile të mbajnë të dhëna të sakta për certifikatat e lëshuara për të gjitha qëllimet, veçanërisht për qëllime zgjedhore, dhe se këto të dhëna duhet të jenë të disponueshme për publikun.

Çështja e certifikatave të lindjes është bërë epiqendër mosmarrëveshjes të mëdha midis shumicës qeverisëse dhe opozitës parlamentare. Qeveria pretendon se ekzistojnë masa të mjaftueshme mbrojtëse për parandalimin e manipulimit të certifikatave. Ajo thekson faktin se në vitin 2006 janë futur certifikata të reja me elemente sigurie shtesë. Këto elemente sigurie shtesë të futura në përdorim nga DPGjC-ja përfshijnë printimin në certifikatë të emrit të bashkisë ose komunës së bashku me kodin e saj shifror, një hologramë, dy vula, dhe nënshkrimin e nëpunësit të gjendjes civile. Nga korriku 2006, janë prodhuar dhe shpërndarë njërive të qeverisjes vendore certifikata të reja me këto elemente sigurie. Në disa vende, ato filluan t'i lëshohen popullatës nga muaji tetor.

Opozita, nga ana e saj, ka vënë në pikëpyetje cilësinë e certifikatave. Në fillim, ajo ka kërkuar që të prodhohen certifikata të reja, veçanërisht për qëllime zgjedhore, si një parakusht për pjesëmarrjen e saj në zgjedhjet për pushtetin vendor. Më vonë, opozita ndryshoi kërkesën e saj, duke kërkuar tashmë një regjistrim të posaçëm për të rregulluar prodhimin dhe lëshimin e

këtyre certifikatave. Partitë opozitare kanë përmendur gjithashtu çështjen e keqprintimeve në sasi të para të certifikatave të reja, për të cilat, sipas tyre, nuk ishte mbajtur evidencë e saktë. DPGjC-ja ka pranuar se janë shpërndarë certifikata të shtypura keq, por ka thënë se numri i tyre nuk ishte domethënës, dhe për më tepër, ato i ishin kthyer shtypshkronjës që i kishte prodhuar. Megjithatë, duket se ka të dhëna të pamjaftueshme për kthimin e këtyre certifikatave, për ruajtjen e tyre të sigurtë apo për shkatërrimin e tyre.

Për të trajtuar çështjen e certifikatave të parregulta, Ministria e Brendshme lëshoi një udhëzim të posaçëm në tetor 2006, që synonte evidentimin e regjistrimit dhe shkatërrimit të të gjitha certifikatave difektoze të paplotësuara, si dhe Urdhërin No.2656, datë 1 nëntor 2006. Ky urdhër parashikon regjistrimin e detajuar të të gjitha certifikatave të lëshuara nga nëpunësit e zyrave të gjendjes civile në nivel lokal në një regjistër të posaçëm indeksi. Megjithatë, jo të gjitha ZGjC-të duket ta kenë zbatuar këtë urdhër në një kohë aq të hershme sa parashikohej. Vëzhguesit afatgjatë të zgjedhjeve raportuan se në disa vende, ZGjC-të filluan ta përdornin regjistër të posaçëm indeksi një muaj pas lëshimit të këtij urdhëri.

Shumica dhe opozita dukej se ishin afër arritjes së një marrëveshjeje për këtë çështje më 29 dhjetor; prapëseprapë, disa orë pas arritjes së saj dolën disa mosmarrëveshje të tjera lidhur me çështjen e mundësisë që i jepej zgjedhësve për të përdorur certifikata lindjeje të lëshuara përpara se regjistrimi i certifikatave në një regjistër të posaçëm indeksi të bëhej i detyrueshëm. Opozita kërkoi që këto certifikata të konsideroheshin të vlefshme në rast se zgjedhësit do të paraqisnin dokumente identifikimi shtesë, konkretisht pasaportë dhe letërnjoftim. Partia Demokratike në pushtet i qëndroi tekstit të marrëveshjes, e cila në ngjashmëri me një vendim të KQZ-së të marrë për këtë çështje pak kohë para zgjedhjeve parlamentare të 2005-ës, përfshinte një gamë më të gjerë dokumentesh. Bisedimet dypalëshe rreth kësaj çështjeje dështuan po atë mbrëmje dhe asgjë e re nuk u arrit në Kuvend.

Media

Që nga data 13 dhjetor, Misioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve të OSBE/ODIHR-it ka bërë një monitorim sasior dhe cilësor të tre stacioneve televizive kombëtare (televizionit publik – TVSH dhe televizioneve private TV Klan dhe TV Arbëria) dhe tre kanaleve televizive me qendër në Tiranë (Top Channel, Vizion+ dhe News 24). Përveç tyre, po monitorohen tre gazeta të përditshme (Gazeta Shqiptare, Shekulli dhe Shqip).

Megjithatë, gjatë periudhës zgjedhore, respektimi i Kodit Zgjedhor mbikqyret nga Bordi i Monitorimit të Medias (BMM) që emërohet dhe vepron nën autoritetin e KQZ-së. Bazuar në raportet e BMM-së ose duke vepruar mbi ankesat e marra, KQZ-ja mund të vendosë sanksione për mosrespektim të rregullave në lidhje me mediat.

Megjithëse BMM-ja u mbledh për herë të parë më 12 dhjetor, në mungesë të kandidatëve të regjistruar, ajo ende nuk ka filluar të ushtrojë monitorimin e medias. Fushata politike në media ka qenë deri tani e pakët dhe është kufizuar kryesisht në mbulimin e prezantimit të kandidatëve të disa partive dhe disa reklamave politike me pagesë.

Situata aktuale, veçanërisht mungesa e kandidatëve të regjistruar, ka krijuar disa pasiguri përse i përket bërjes së fushatës nga disa kandidatë, që janë përcaktuar nga forcat politike, por që nuk janë regjistruar ende. Në mënyrë të veçantë, duket se ka disa pasiguri përse i përket mënyrës se si duhet të trajtohet një mbulim i tillë sipas rregullave aktuale.

Aktivitetet e MVZ-së së OSBE/ODIHR-it

Misioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve (MVZ) i OSBE/ODIHR-it e hapi zyrën e tij në Tiranë më 13 dhjetor 2006. Kryetari i Misionit është takuar me Presidentin, Kryeministrin, Kryetaren e Kuvendit, Zëvendëskryeministrin, Ministrin e Punëve të Jashtme, Ministrin e Brendshëm, Ministrin e Mbrojtjes, Kryetarin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe zyrtarë të tjerë. MVZ-ja ka vendosur kontakte të rregullta me Ministrinë e Punëve të Jashtme, Ministrinë e Brendshëm, Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe komunitetin diplomatik, si dhe me partitë politike kryesore. MVZ-ja ka bërë disa takime fillestare me parti politike, shoqërinë civile, komisione zgjedhore, median dhe bashkëbisedues të tjerë. Një prezantim i parë për përfaqësuesit e komunitetit diplomatik dhe organizatave ndërkombëtare të akredituara në Republikën e Shqipërisë u mbajt më 21 dhjetor. Vëzhguesit afatgjatë të shpërndarë në vend në 11 ekipe vazhdojnë të përpiqen të realizojnë aktivitetin e tyre vëzhgues pavarësisht nga fakti se procesi zgjedhor është bllokuar.